



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 376/4 prot.

Tiranë, më 03.02.2020

VENDIM

Nr. 11, datë 03.02.2020

PËR  
MIRATIMIN E KRITEREVE TË PUNËSIMIT TË PERSONELIT ADMINISTRATIV TË  
UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË

Në bazë të nenit 49, gërma "f" e Ligjit nr.80, datë 22.07.2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", VKM nr.514, datë 20.09.2017 "*Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (lqp)*", të rishikuar, të Statutit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, Vendimin e Senatit Akademik nr.12, datë 11.02.2019 "*Për miratimin e strukturës organizative të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë*" i ndryshuar, të Vendimit të Bordit të Administrimit nr. 40, datë 04.07.2019 "*Për miratimin e numrit të personelit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, në të gjitha nivelet*" i ndryshuar, si dhe të shkresës së Administratorit nr. 2277 prot. datë 27.08.2019 "*Propozim i kriterëve dhe procedurave për punësimin e personelit administrativ*", pas diskutimit në mbledhjen e përbashkët me Rektoratin, dhe në vijim të diskutimeve të zhvilluara, me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë kriteret e punësimin për personelin administrativ të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ky vendim ka efekt vetëm për vendet që janë aktualisht vakante, sipas listës bashkangjitur.
3. Për vakancat e krijuara pas zbatimit të këtij vendimi, Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, kërkon miratimin e Bordit të Administrimit për ndryshime të mundshme në kriteret dhe procedurat e punësimin.
4. Ngarkohet Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë dhe personat përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi.

*Ky vendim hyn në fuqi në datën e protokollimit.*

KRYETARI  
Florian TOTI



REKTORATI				
PERSONELI ADMINISTRATIV				
Struktura/Pozicioni i punës	Nr. Total Struktura e re	Nr. Personel aktual	Vende të lira (vakant)	Kategoria e pagës
<b>I. REKTORATI</b>				
<b>V. Drejtoria Ekonomike</b>	<b>8</b>	<b>3</b>	<b>5</b>	
Drejtor	1	1	0	III-a
<b>V.1 Sektori i Financës</b>	<b>4</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	
Përgjegjës	1	1	0	III-b
Specialist	3	1	2	IV-a
<b>V.2 Sektori i Buxhetit</b>	<b>3</b>	<b>0</b>	<b>3</b>	
Përgjegjës	1	0	1	III-b
Specialist	2	0	2	IV-a
<b>VI. Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse</b>	<b>13</b>	<b>7</b>	<b>6</b>	
Drejtor	1	0	1	III-a
<b>VI.1 Sektori i Prokurimeve</b>	<b>4</b>	<b>3</b>	<b>1</b>	
Përgjegjës	1	1	0	III-b
Specialist	3	2	1	IV-a
<b>VI.2 Sektori i Shërbimeve dhe Investimeve</b>	<b>8</b>	<b>4</b>	<b>4</b>	
Përgjegjës	1	0	1	III-b
Specialist	3	1	2	IV-a
Sanitar	2	2	0	Klasa I
Punonjës mirëmbajtje	1	1	0	Klasa IV
Teknik i mesëm i specialiteteve te ndryshme	1	0	1	Klasa VI
<b>VII. Njësia e Auditimit të Brendshëm</b>	<b>3</b>	<b>2</b>	<b>1</b>	
Përgjegjës	1	1	0	III-b
Specialist	2	1	1	IV-a
<b>Total</b>	<b>24</b>	<b>12</b>	<b>12</b>	

**FAKULTETI I MJEKESISE**

**PERSONELI ADMINISTRATIV**

Struktura /Pozicioni i punës	Nr. Total Struktura e re	Nr. personel aktual	Vënde të lira (vakant)	Kategoria e pagës
Administratori	1	1	0	III-a1
<b>1. Dega e Financës</b>				
Kryetare e Degës	1	0	1	IV-a
Specialist Finance	3	3	0	IV-a
<b>2. Dega e Mënaxhimit të Shërbimeve</b>				
Kryetar i Degës	1	0	1	IV-a
Specialist i prokurimeve	1	1	0	IV-a
Magaznier	1	1	0	Klasa VI
Teknik i Mesëm i Specialiteteve të ndryshme	3	0	3	Klasa VI
Punëtor Mirëmbajtje	1	1	0	Klasa IV
Sanitare	16	13	3	Klasa I
<b>TOTAL</b>	<b>28</b>	<b>20</b>	<b>8</b>	



*Abajlo*

**FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE**

**PERSONELI ADMINISTRATIV**

Struktura/Pozicioni i punës	Nr. Total Struktura e re	Nr. personel aktual	Vënde të lira (vakant)	Kategoria e pagës
Administratori	1	0	1	III-a1
<b>1. Dega e Financës</b>				
Kryetare e Degës	1	0	1	IV-a
Specialist Finance	2	3	-1	IV-a
<b>2. Dega e Menaxhimit të Shërbimeve</b>				
Kryetar i Degës*	1	1	0	IV-a
Specialist i prokurimeve	1	0	1	IV-a
Magazinier	1	1	0	Klasa VI
Teknik i Mesëm i Specialiteteve të ndryshme	2	1	1	Klasa VI
Sanitare	10	8	2	Klasa I
<b>TOTALI</b>	<b>19</b>	<b>14</b>	<b>5</b>	

\* Shënim: Vendet e punes te meposhteme jane me komandim dhe duhet te kryhet procedurat e konkursit:

Kryetar i deges se sherbimeve. (A.Hoxha)

Specialiste finance (N.Refatllari)

Magazinjer (D.Rroga)

Teknik i specialiteteve te ndryshme (R.Cullufe)




FAKULTETI I MJEKESISE DENTARE				
PERSONELI ADMINISTRATIV				
Struktura/Pozicioni i punës	Nr. Total Struktura e re	Nr. personel aktual	Vënde të lira (vakant)	Kategoria e pagës
Administratori	1	1	0	III-al
<b>1. Dega e Financës</b>				
Kryetare e Degës	1	0	1	IV-a
Specialist Finance	1	1	0	IV-a
<b>2. Dega e Menaxhimit të Shërbimeve</b>				
Kryetar i Degës	1	0	1	IV-a
Teknik i Mesëm i Specialiteteve të ndryshme & Magazinier	1	0	1	Klasa e VI
Sanitare*	2	1	1	Klasa e I
<b>TOTALI</b>	<b>7</b>	<b>3</b>	<b>4</b>	

\* Aktualisht ne pozicionin e punes sanitare edhe punonjesja që është në punë eshte me komandim.  
Duhet të kalojë në konkurs.








REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
ADMINISTRATORI

**I. PËRSHKRIMI I PUNËS DHE KRITERET E PUNËSIMIT PËR PERSONELIN ADMINISTRATIV TË UMT-së.**

Përshkrimi i drejtimeve kryesore të punës dhe kriteret e punësimit për çdo pozicion janë hartuar bazuar në:

- Ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”,
- ligjin 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar,
- VKM nr.514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (lqp), të rishikuar”,
- VKM nr.187, datë 08.03.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit” e ndryshuar,
- VKM nr.717, datë 23.06.2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore” e ndryshuar,
- strukturën e miratuar nga Senati Akademik me Vendimin nr.12, datë 11.02.2019 “Për miratimin e strukturës organizative të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë” i ndryshuar me Vendimin nr.48, datë 24.07.2019 “Për disa ndryshime në Vendimin nr.12, datë 11.02.2019 ...”, dhe
- nga Bordi i Administrimit me Vendim nr. 40, datë 04.07.2019 “Për miratimin e numrit të personelit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, në të gjitha nivelet” dhe Vendim nr. 47, datë 30.07.2019 “Për disa ndryshime në vendimin e Bordit të Administrimit nr.40, datë 04.07.2019 ...”

**Si reference është përdorur:**

- Ligji nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, VKM nr.142, datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Institucionet e Pavarura” e ndryshuar,
- VKM nr.125, datë 17.02.2016 “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunëve civil”,
- Udhëzimi nr.1, datë 31.05.2017 “Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil”, të DAP-it,
- Shkresa nr.4181/1 prot, datë 30.07.2019 “Kthim përgjigje”, e DAP.

Shënim: Më poshtë, është ruajtur renditja sipas strukturës së miratuar.

	<b>Emërtimi i vendit të punës sipas strukturës</b>	<b>Përshkrimi i punës</b>	<b>Grupi-Nëngrupi i punës sipas LKP</b>	<b>Kërkesat për vendin e punës</b>
1	<i>Asistente e Administratorit</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Organizon e siguron rregullsinë e hyrjes së të gjitha materialeve informative për Administratorin.</li> <li>• Organizon axhendën ditore të Administratorit.</li> <li>• Nëpërmjet Sektorit të Protokoll-Arkivës siguron transmetimin korrekt të korrespondencës së Administratorit brenda institucionit apo në marrëdhënie jashtë tij.</li> <li>• Mban evidencën e porosive që merr prej prej nëpunëve të Institucionit apo personave të tretë dhe ndjek përfundimin e dhënies së përgjigjes.</li> <li>• Kordinon takimet e planifikuara për Administratorin me nëpunësit apo me personat jashtë saj.</li> </ul>	334	<p><b>Kriteret</b></p> <p>a. Të ketë përfunduar studimet universitare dhe të jetë i pajisur me një diplomë të studimeve bachelor apo të barasvlefshme me to, sipas kuadrit ligjor të arsimit të lartë;</p> <p>c. Aftësi të mira kompjuterike, njohja e programeve bazë;</p> <p>d. Njohuri të gjuhës së huaj anglisht dhe/ose ndonjë gjuhë tjetër.</p>



		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Asiston dhe mban proces-verbalet në mbledhjet e ndryshme, duke nënvizuar konkluzionet dhe detyrat që dalin nga këto mbledhje.</li> <li>• Detyrat e tjera janë specifikuar në rregulloren e përgjithshme.</li> </ul>		<p><b>Kushtet</b></p> <p>a. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.</p> <p>b. Të jete në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.</p> <p>c. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje.</p> <p>d. Ndaj tij të mos jetë marrë ndonjë masë disiplinore për largimin nga detyra.</p> <p>Përbën avantazh për këto pozicion aftësia në komunikim, aftësia organizative dhe manaxheriale, aftësia për të punuar në grup.</p>
2	<i>Drejtor i Drejtorisë Ekonomike</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Drejtori i Drejtorisë është përgjegjësi kryesor për mbarëvajtjen e punës në Drejtori. Koordinon punën vertikalisht me strukturat që ka në varësi: përgjegjës sektori, specialist dhe raporton rregullisht te Administratori i UMT-së.</li> <li>• Kryen funksionin e nëpunësit zbatues.</li> <li>• Ndjek realizmin e detyrave të ngarkuara nga ligji, ose nga eprori brenda afatit dhe raportimin në kohë të tyre.</li> <li>• Menaxhon dhe ndjek zbatimin e gjithë procedurave financiare të ndarjes dhe realizimit të zërave të buxhetit të Universitetit sipas legjislacionit në fuqi dhe në lidhje të ngushtë me institucionet financiare shtetërore;</li> </ul>	1211 01 02 03	<p><b>Kriteret</b></p> <p>a. Të ketë përfunduar studimet universitare dhe të jetë i pajisur me një diplomë të studimeve “master shkencor” në “shkencat ekonomike” apo të barasvlefshme me to, sipas kuadrit ligjor të arsimit të lartë;</p> <p>b. Të ketë mbi 5 vite eksperiencë pune të mëparshme në të njëjtin pozicion ose pozicione të ngjashme;</p> <p>c. Aftësi të mira kompjuterike, njohja e programeve bazë;</p>



	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mbikqyr të gjithë veprimet për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm dhe vjetor të Universitetit dhe përgatit raportet për Administratorin e UMT-së dhe organet kolegjiale.</li> <li>• Siguron mbajtjen e librave të llogarisë, pagat, kontratat, pagesat, menaxhimin e bilancit të cash-it, hartimin e pasqyrave financiare periodike dhe analizave të tyre.</li> <li>• Është përgjegjës për raportimet periodike për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë si dhe raportime financiare të kërkuara jashtë rradhe nga institucione të ndryshme;</li> <li>• Realizon përdorimin me efikasitet dhe efektivitet të burimeve financiare duke respektuar parimet e transparencës, mirëbesimit dhe ligjshmërisë, si dhe shmangien e shpërdorimit, keqpërdorimit e vjedhjes së pasurisë.</li> <li>• Është përgjegjës për menaxhimin e fondeve të projekteve të huaja të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë</li> <li>• Është përgjegjës për kryerjen vjetore të inventareve të magazinës dhe të aseteve të Rektoratit si dhe udhëzon dhe ndjek kryerjen e inventareve nga ana e njësive shpenzuese të Universitetit;</li> <li>• Detyrat e tjera janë specifikuar në rregulloren e përgjithshme.</li> </ul>		<p>d. Njohuri të gjuhës së huaj anglisht dhe/ose ndonjë gjuhë tjetër.</p> <p><b>Kushtet</b></p> <p>a. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.</p> <p>b. Të jete në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.</p> <p>c. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje.</p> <p>d. Ndaj tij të mos jetë marrë ndonjë masë disiplinore për largimin nga detyra.</p> <p>Përbën avantazh për këto pozicion aftësia në komunikim, aftësia organizative dhe manaxheriale, aftësia për të punuar në grup.</p>
--	---	--	--

3	Përgjegjës në Sektorin e Buxhetit	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përgjegjësi i Sektorit është përgjegjësi kryesor për mbarëvajtjen e punës në Sektor. Koordinon punën vertikalisht me strukturat që ka në varësi: specialist dhe raporton rregullisht te Drejtori i Drejtorisë.</li> <li>• Në bashkëpunim me njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë ndjek procesin për planifikon çdo vit, nevojat financiare për zërat e buxhetit të vitit për paga, sigurime, bursa, shpenzime operative dhe investime;</li> <li>• Në bashkëpunim me njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, përgatit dhe harton çdo vit projekt-buxhetin afatmesëm 3 vjeçar të Universitetit në zbatim të kërkesave të ligjit dhe të institucioneve përkatëse;</li> <li>• Konstaton dhe bazuar në analiza përgatit raporte për probleme të ndryshme të menaxhimit të fondeve.</li> <li>• Kryen ndjekjen e kostove të programeve kryesore të UMT-së.</li> <li>• Përgatit materialet për rialokimet e fondeve, sipas kërkesave të njërive shpenzuese të UMT-së.</li> <li>• Në bashkëpunim me sektorët e tjerë përgatit analizat për realizimin e fondeve.</li> <li>• Detyrat e tjera janë specifikuar në rregulloren e përgjithshme.</li> </ul>	2619 05	<p><b>Kritere</b></p> <p>a. Të ketë përfunduar studimet universitare dhe të jetë i pajisur me një diplomë të studimeve “master shkencor” në “shkencat ekonomike” apo të barasvlefshme me to, sipas kuadrit ligjor të arsimit të lartë;</p> <p>b. Të ketë mbi 3 vite eksperiencë pune të mëparshme në të njëjtin pozicion ose pozicione të ngjashme;</p> <p>c. Aftësi të mira kompjuterike, njohja e programeve bazë;</p> <p>d. Njohuri të gjuhës së huaj anglisht dhe/ose ndonjë gjuhë tjetër.</p> <p><b>Kushtet</b></p> <p>a. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.</p> <p>b. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.</p> <p>c. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje.</p> <p>d. Ndaj tij të mos jetë marrë ndonjë masë disiplinore për largimin nga detyra.</p>
---	-----------------------------------	--	------------	--






				Përbën avantazh për këtë pozicion aftësia në komunikim, aftësia organizative dhe manaxheriale, aftësia për të punuar në grup.
4	<i>Specialist në Sektorin e Buxhetit.</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Merr pjesë në hartimin e buxhetit vjetor, në bashkëpunim me njësitë shpenzuese të UMT-së.</li> <li>• Merr pjesë në përgatitjen e programit buxhetor afatmesem në zbatim të kërkesave të ligjit dhe institucioneve përkatëse.</li> <li>• Konstaton dhe bazuar në analiza përgatit raporte për probleme të ndryshme të menaxhimit të fondeve.</li> <li>• Kryen ndjekjen e kostove të programeve kryesore të UMT-së.</li> <li>• Përgatit materialet për rialokimet e fondeve, sipas kërkesave të njërive shpenzuese të UMT-së.</li> <li>• Propozon parashikime për një menaxhim optimal të të ardhurave dhe shpenzimeve.</li> <li>• Raporton për punën e kryer dhe problemet e konstatuara përpara përgjegjësi të sektorit.</li> <li>• Realizon çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga epërorët.</li> <li>• Detyrat e tjera janë specifikuar në rregulloren e përgjithshme.</li> </ul>	2631 03	<p><b>Kritere</b></p> <p>a. Të ketë përfunduar studimet universitare dhe të jetë i pajisur me një diplomë të studimeve “master profesional” ose “bachelor” në “shkencat ekonomike” apo të barasvlefshme me to, sipas kuadrit ligjor të arsimit të lartë;</p> <p>b. Të ketë 1 vit eksperiencë pune të mëparshme në të njëjtin pozicion ose pozicione të ngjashme;</p> <p>c. Aftësi të mira kompjuterike, njohja e programeve bazë;</p> <p>d. Njohuri të gjuhës së huaj anglisht dhe/ose ndonjë gjuhë tjetër.</p> <p><b>Kushtet</b></p> <p>a. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.</p> <p>b. Të jete në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.</p>

				<p>c. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje.</p> <p>d. Ndaj tij të mos jetë marrë ndonjë masë disiplinore për largimin nga detyra.</p>
5	<i>Përgjegjës në Sektorin e Financës</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përgjegjësi i Sektorit është përgjegjësi kryesor për mbarëvajtjen e punës në Sektor. Koordinon punën vertikalisht me strukturat që ka në varësi: specialist dhe raporton rregullisht te Drejtori i Drejtorisë.</li> <li>• Ndjek gjithë veprimet financiare që lidhen me shpenzimet për veprimtarinë e UMT-së, bën mbylljen e bilancit vjetor për gjithë Universitetin e Mjekësisë Tiranë.</li> <li>• Përgatit bilancin vjetor të njësisë qendrore të UMT-së dhe bilancin e konsoliduar për Universitetin.</li> <li>• Ndjek shpenzimet e buxhetit dhe të fondeve të tjera që disponon universiteti, rakordon çdo muaj situacionin e shpenzimeve ekonomike, si dhe propozon, rialokime të planit buxhetor për çdo njësi shpenzuese, nëse është e nevojshme;</li> <li>• Në bashkëpunim me sektorin e buxhetit përgatit analiza periodike dhe vjetore për realizimin e treguesve ekonomik dhe financiarë.</li> </ul>	2619 05	<p><b>Kritere</b></p> <p>a. Të kenë përfunduar studimet universitare dhe të jenë të pajisur me një diplomë të studimeve “master shkencor” në “shkencat ekonomike” apo të barasvlefshme me to, sipas kuadrit ligjor të arsimit të lartë;</p> <p>b. Të ketë mbi 3 vite eksperiencë pune të mëparshme në të njëjtin pozicion ose pozicione të ngjashme;</p> <p>c. Aftësi të mira kompjuterike, njohja e programeve bazë;</p> <p>d. Njohuri të gjuhës së huaj anglisht dhe/ose ndonjë gjuhë tjetër.</p> <p><b>Kushtet</b></p> <p>a. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.</p>



		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përgatit raportet për Ministrinë e Financave në formë elektronike dhe shkresore periodikisht (çdo muaj) dhe jashtë radhe për të gjitha të dhënat që kërkohen;</li> <li>• Është përgjegjës për mbajtjen e librave të llogarisë në përputhje me legjislacionin në fuqi.</li> <li>• Është përgjegjës dhe përgatit të gjithë materiet e nevojshme për kryerjen e inventarëve të përgjithshme dhe periodike për njësinë qendrore të UMT-së.</li> <li>• Koordinon aktivitetin e punës midis specialistëve, cakton detyra dhe ndjek e kontrollon zbatimin e tyre;</li> <li>• Regjistron të gjitha kontratat e lidhura ndërmjet Universitetit të Mjekësisë dhe operatorëve ekonomik. Ndjek likuidimin e tyre;</li> <li>• Detyrat e tjera janë specifikuar në rregulloren e përgjithshme.</li> </ul>		<p>b. Të jete në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.</p> <p>c. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje.</p> <p>d. Ndaj tij të mos jetë marrë ndonjë masë disiplinore për largimin nga detyra.</p> <p>Përbën avantazh për këto pozicion aftësia në komunikim, aftësia organizative dhe manaxheriale, aftësia për të punuar në grup.</p>
6	<i>Specialist në Sektorin e Financës</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndjek dhe zbaton të gjitha procedurat të lidhura me veprimet që gjenerojnë shpenzimet dhe të ardhurat dhe garanton përputhshmëri me ligjin.</li> <li>• Ndjek dhe kryen regjistrimet në librat e llogarisë të të gjitha veprimeve që lidhen me të ardhurat.</li> <li>• Ndjekin dhe kryejnë regjistrimet në librat e llogarisë të të gjitha veprimeve që lidhen me shpenzimet e njësisë qendrore të UMT-së. Regjistron në bazë të dokumentacionit, të</li> </ul>	2631 03	<p><b>Kritere</b></p> <p>a. Të ketë përfunduar studimet universitare dhe të jetë i pajisur me një diplomë të studimeve, “master profesional” ose “bachelor” në “shkencat ekonomike” apo të barasvlefshme me to, sipas kuadrit ligjor të arsimit të lartë;</p> <p>b. Të ketë 1 vit eksperiencë pune të mëparshme në të njëjtin pozicion ose pozicione të ngjashme;</p>

7	<p><i>Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Drejtori i Drejtorisë është përgjegjësi kryesor për mbarëvajtjen e punës në Drejtori. Koordinon punën vertikalisht me strukturat që ka në varësi dhe raporton rregullisht te Administratori i UMT-së.</li> <li>• Organizon dhe drejton të gjithë procesin për organizimin e prokurimeve publike për tenderat e përqëndruara për njësinë shpenzuese dhe prokurimet për njësinë qendrore të UMT-së.</li> <li>• Organizon dhe drejton të gjithë procesin për përcaktimin e kriterëve ligjore për lidhjen e kontratave me operatorët fitues.</li> <li>• Monitoron zbatimin e kontratave të lidhura.</li> <li>• Përgjegjës për hedhjen në kohë të Regjistrit të parashikimit të prokurimeve publike dhe ndjekjen e raportimeve në kohë në MASR-së.</li> <li>• Kontrollon dhe miraton të dhënat dhe analizat në fushën e prokurimeve.</li> <li>• Koordinon dhe kontrollon veprimtarinë e sektorëve të drejtorisë së tij;</li> <li>• Punon për përgatitjen dhe propozon politika dhe strategji për Drejtorinë;</li> <li>• Organizon punën për kryerjen e studimeve, raporteve të ndryshme;</li> <li>• Organizon dhe drejton punën e drejtorise si dhe mundëson kushtet normale me qëllim përmbushjen e plotë dhe brenda afateve të detyrave;</li> <li>• Kontrollon, analizon dhe vlerëson mbi rezultatet e punës së punonjësve në varësi të tij;</li> </ul>	<p>1211 01 02 03</p>	<p><b>Kritere</b></p> <p>a. Të ketë përfunduar studimet universitare dhe të jetë i pajisur me një diplomë të studimeve “master shkencor” në shkencat “ekonomike”, “juridik”, “inxhinieri dhe teknologji” apo të barasvlefshme me to, sipas kuadrit ligjor të arsimit të lartë;</p> <p>b. Të ketë mbi 5 vite eksperiencë pune të mëparshme në të njëjtin pozicion ose pozicione të ngjashme;</p> <p>c. Aftësi të mira kompjuterike, njohja e programeve bazë;</p> <p>d. Njohuri të gjuhës së huaj anglisht dhe/ose ndonjë gjuhë tjetër.</p> <p><b>Kushtet</b></p> <p>a. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.</p> <p>b. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.</p> <p>c. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje.</p> <p>d. Ndaj tij të mos jetë marrë ndonjë masë disiplinore për largimin nga detyra.</p>
---	--	---	----------------------------------	--



		<p>gjitha veprimet ekonomike financiare në mënyrë kronologjike dhe sistematike në regjistrat kontabël, ditarë: (ditari i shpenzimeve, ditari i bankës, ditari i magazinës, ditari i pagave, ditari i veprimeve të ndryshme).</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përgatit e përpilon situacionet e raportimit të ardhurave dhe shpenzimeve si UMT, si dhe tabelat e raportimit progresiv, periodikisht çdo 4 -muor, në bazë të raportimeve progresive të dërguara nga çdo njësi shpenzuese.</li> <li>• Mban dhe azhuron në mënyrë kronologjike gjendjen e Aktiveve të Qëndrueshme, kartelat e AQT-ve në përdorim (zyrë dhe çdo punonjës) për njësinë qendrore të UMT-së si dhe llogarit amortizimin e tyre.</li> <li>• Mban, azhuron dhe kontabilizon të gjitha veprimet e magazinës qendrore të UMT-së dhe përgatit raportet mujore të gjëndjes.</li> <li>• Mban, azhuron dhe kontabilizon të gjitha veprimet e pagave të punonjësve dhe të gjitha detyrimet që rrjedhin prej tyre (sig. shoqërore, pensionet etj).</li> <li>• Raporton për punën e kryer dhe problemet e konstatuara përpara përgjegjësit të sektorit.</li> <li>• Realizon çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga epërorët.</li> <li>• Detyrat e tjera janë specifikuar në rregulloren e përgjithshme.</li> </ul>		<p>c. Aftësi të mira kompjuterike, njohja e programeve bazë;</p> <p>d. Njohuri të gjuhës së huaj anglisht dhe/ose ndonjë gjuhë tjetër.</p> <p><b>Kushtet</b></p> <p>a. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.</p> <p>b. Të jete në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.</p> <p>c. Të mos jetë denuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje.</p> <p>d. Ndaj tij të mos jetë marrë ndonjë masë disiplinore për largimin nga detyra.</p>
--	--	---	--	--

		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Analizon kryerjen e detyrave dhe jep opinione në lidhje me to;</li> <li>• Detyrat e tjera janë specifikuar në rregulloren e përgjithshme.</li> </ul>		
8	<i>Përgjegjës i Sektorit të Prokurimeve.</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përgjegjësi i Sektorit është përgjegjësi kryesor për mbarëvajtjen e punës në Sektor. Koordinon punën vertikalisht me strukturat që ka në varësi dhe raporton rregullisht te Drejtori i Drejtorisë.</li> <li>• Mbajtja e përgjegjësisë për respektimin e të gjitha rregullave dhe të afateve të caktuara në aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, për saktësinë dhe bazueshmërinë ligjore të të gjitha akteve që dalin nga Sektori i Prokurimit, duke u mbështetur në legjislacionin përkatës;</li> <li>• Hartimi dhe propozimi i planit vjetor të prokurimeve, në bashkëpunim me Njësinë e Prokurimit në bazë të kërkesave dhe nevojave për prokurim;</li> <li>• Organizon punën për përgatitjen e regjistrit të parashikimeve të prokurimit publik shpenzimeve dhe investimeve në bashkëpunim me Njësinë e Prokurimit, në fillim të çdo viti kalendarik;</li> <li>• Përgatitja e Dokumentave Standarde të Tenderit për procedurat e prokurimit, në bashkëpunim me anëtarët e Njësisë së</li> </ul>	2619 05	<p><b>Kritere</b></p> <p>a. Të ketë përfunduar studimet universitare dhe të jetë i pajisur me një diplomë të studimeve “master shkencor” në shkencat “ekonomi”, “juridik”, “inxhinieri dhe teknologji” apo të barasvlefshme me to, sipas kuadrit ligjor të arsimit të lartë;</p> <p>b. Të ketë mbi 3 vite eksperiencë pune të mëparshme në të njëjtin pozicion ose pozicione të ngjashme;</p> <p>c. Aftësi të mira kompjuterike, njohja e programeve bazë;</p> <p>d. Njohuri të gjuhës së huaj anglisht dhe/ose ndonjë gjuhë tjetër.</p> <p><b>Kushtet</b></p> <p>a. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.</p>



		<p>Prokurimit, sipas pjesëmarrjes në komisionet përkatëse në procedurë;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përgatitja e analizave periodike për prokurimet.</li> <li>• Përgatitja e regjistrit të realizimit të prokurimeve publike në mënyrë periodike dhe vjetore, raportimi në MASR-ë.</li> <li>• Kontrollon dhe shpërndan sipas destinacionit dokumentat e hartuara nga punonjësit në varësi;</li> <li>• Siguron bashkëpunim të mirë të grupit dhe ekzekutim në kohë të detyrave</li> <li>• Siguron që mbajtja dhe arkivimi i të dhënave të Sektorit është në përputhje me kërkesat dhe rregullat e dokumentacionit për prokurimin publik;</li> <li>• Identifikon, vlerëson dhe menaxhon risqet operationale dhe bashkëpunon me Sektorin Juridik për çdo risk të hasur;</li> <li>• Siguron që stafi i caktuar për implementimin e kontratës të mos jetë i përfshirë në vlerësimin e tenderit</li> <li>• Përgatit planifikimin e procedurave të tenderimit në bashkëpunim me drejtoritë/sectorët e tjerë (përgatitja dhe ndjekja e rregullt të Planit të Prokurimit);</li> <li>• Monitoron dhe rishikon aktivitetet e prokurimit dhe dokumentat e tenderit, në mënyrë që të sigurojë që procedurat të jenë zbatuar në kohën e duhur nga punonjësit e varësisë;</li> </ul>	<p>b. Të jete në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.</p> <p>c. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje.</p> <p>d. Ndaj tij të mos jetë marrë ndonjë masë disiplinore për largimin nga detyra.</p>
--	--	--	---




		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Siguron transmetimin e kërkesës për hapjen e tenderit (parashikimin dhe njoftimet për tender në internet, ftesat drejtuar tenderuesve) dhe monitoron procesin e parakualifikimit dhe të përzgjedhjes;</li> <li>• Në fund të vitit ndjek dhe mbikëqyr hartimin dhe dorëzimin e Regjistrit përmbledhës për Realizimin e Prokurimeve publike, konform afateve të përcaktuara në ligj.</li> </ul>		
9	<i>Specialist në Sektorin e Prokurimeve.</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mbajtja e përgjegjësisë për respektimin e të gjitha rregullave dhe të afateve të caktuara në aktet ligjore e nënligjore për prokurimin publik, për saktësinë dhe bazueshmërinë ligjore të të gjitha akteve që dalin nga Sektori i Prokurimit, duke u mbështetur në legjislacionin përkatës.</li> <li>• Përgatitja e Dokumenteve Standarde të Tenderit në bashkëpunim me anëtarët e tjerë të Njesisë së Prokurimit, për zbatimin e procedurave të prokurimit sipas kërkesave të parashikuara në ligj;</li> <li>• Merr pjesë gjithë procesin për përcaktimin e kriterëve ligjore për lidhjen e kontratave me operatorët fitues.</li> <li>• Përgatit regjistrin e parashikimit të prokurimeve, konform buxhetit të miratuar për investime dhe për shpenzime;</li> <li>• Hartimin e specifikimeve teknike nëse nuk janë hartuar nga struktura të tjera</li> </ul>	2631 15	<p><b>Kritere</b></p> <p>a. Të ketë përfunduar studimet universitare dhe të jetë i pajisur me një diplomë të studimeve, “master profesional” ose “bachelor” në shkencat “ekonomi”, “juridik”, “inxhinieri dhe teknologji”, “natyrore” apo të barasvlefshme me to, sipas kuadrit ligjor të arsimit të lartë;</p> <p>b. Të ketë 1 vit eksperiencë pune të mëparshme në të njëjtin pozicion ose pozicione të ngjashme;</p> <p>c. Aftësi të mira kompjuterike, njohja e programeve bazë;</p> <p>d. Njohuri të gjuhës së huaj anglisht dhe/ose ndonjë gjuhë tjetër.</p> <p><b>Kushtet</b></p> <p>a. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.</p>



		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përlllogaritjen e fondit limit, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukturë të posaçme;</li> <li>• Përgatitjen e procedurës për KVO-në;</li> <li>• Asiston në mbledhjet e KVO-së dhe jep mendim si dhe bën interpretim ligjor për Dokumentat e tenderit, atëhere kur i kërkohet nga anëtarët e KVO-së;</li> <li>• Zbaton detyrat e ngarkuara sipas rregulloreve në fuqi dhe përshkrimit të vendit të punës si dhe planeve të punës të miratuara nga Drejtori përkatës;</li> <li>• Informon eprorin direkt mbi rezultatet e punëve në vazhdimësi dhe mbi vështirësitë e hasura në lidhje me to;</li> <li>• Realizon çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga eprorët.</li> <li>• Detyrat e tjera janë specifikuar në rregulloren e përgjithshme.</li> </ul>		<p>b. Të jete në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.</p> <p>c. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje.</p> <p>d. Ndaj tij të mos jetë marrë ndonjë masë disiplinore për largimin nga detyra.</p>
10	<i>Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përgjegjësi i Sektorit është përgjegjësi kryesor për mbarëvajtjen e punës në Sektor. Koordinon punën vertikalisht me strukturat që ka në varësi dhe raporton rregullisht te Drejtori i Drejtorisë.</li> <li>• Ndjek monitorimin e zbatimit të kontratave të lidhura.</li> <li>• Organizon punën për mirëfunksionimin e sistemeve dhe infrastrukturës elektromekanike, hidraulike, ndërtimore të godinës të UMT-së, si dhe të pajisjeve të tjera</li> </ul>	2635 02	<p><b>Kritere</b></p> <p>a. Të ketë përfunduar studimet universitare dhe të jetë i pajisur me një diplomë të studimeve “master shkencor” në shkencat “ekonomi”, “inxhinieri dhe teknologji”, “juridik”, “natyrore”, “humane”, apo të barasvlefshme me to, sipas kuadrit ligjor të arsimit të lartë;</p>

		<p>që janë në përdorim në përputhje me parametrat e duhura;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Organizon punën për mirëmbajtjen, pastrimin, transportin, shërbimet postare dhe korrierët.</li> <li>• Mbikqyr evidentimin e mallrave dhe materialeve në magazinë, dokumentimin e qarkullimit të tyre, mbajtjen e kartelave dhe rakordimin me kontabilitetin;</li> <li>• Organizon punën për plotësimin e regjistrit të aseteve të UMT-së duke evidentuar ndryshimet (rikonstruksionet, meremetimet)</li> <li>• Organizon punën për mbajtjen e regjistrit të pronave të miratuara për t'u dhënë me qera.</li> <li>• Realizon çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga epërorët.</li> <li>• Detyrat e tjera janë të specifikuar në rregulloren e përgjithshme.</li> <li>• Evidenton mallrat dhe materialet në magazinë, dokumentimin e qarkullimit të tyre, mbajtjen e kartelave dhe rakordimin me kontabilitetin;</li> </ul>		<p>b. Të ketë mbi 3 vite eksperiencë pune të mëparshme në të njëjtin pozicion ose pozicione të ngjashme;</p> <p>c. Aftësi të mira kompjuterike, njohja e programeve bazë;</p> <p>d. Njohuri të gjuhës së huaj anglisht dhe/ose ndonjë gjuhë tjetër.</p> <p><b>Kushtet</b></p> <p>a. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.</p> <p>b. Të jete në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.</p> <p>c. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje.</p> <p>d. Ndaj tij të mos jetë marrë ndonjë masë disiplinore për largimin nga detyra.</p>
11	<i>Specialist në Sektorin e Shërbimeve dhe Investimeve</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Monitoron zbatimin e kontratave të lidhura.</li> <li>• Përgjigjen dhe ndjekin mirëfunksionimin e sistemeve dhe infrastrukturës elektromekanike, hidraulike, ndërtimore të godinës të UMT-së, si dhe të pajisjeve të tjera që janë në përdorim në përputhje me parametrat e duhura;</li> </ul>	2141 2142	<p><b>Kritere</b></p> <p>a. Të kenë përfunduar studimet universitare dhe të jenë të pajisur me një diplomë të studimeve “master profesional”, “bachelor” në shkencat “ekonomi”, “inxhinieri dhe teknologji”, “juridik”,</p>



